



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 02/2018

Datë: 22. 01.2018. Ora: 11:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesues i mbledhjes: Ercan Spat, anëtar i KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Stevan Veselinoviq, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Ercan Spat, kryesues i mbledhjes së KQZ-së

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes të KQZ-së nr.01/ 2018;

2. **Aktivitetet e ZRPP-së:**

- Shqyrtimi dhe miratimi i draft vendimit për caktimin e lartësisë së mjeteve nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike për vitin 2018;

3. Raport i Këshillave të KQZ-së:

- Këshilli i Operacioneve Zgjedhore

- Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës i KQZ-së për vitin 2018,

- Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Projektit për Ditën Globale të Zgjedhjeve,

- **Këshilli për Çështje Ligjore:**

- *Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarëve të kuvendeve ;*
- *Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për mos pranim të ndryshimit të emrit të partisë politike nga “Bosnjacka Stranka Demokratske Akcije Kosova-BSDAK” në “Evropska Stranka Demokratske Akcije-ESDA*

Këshilli për Buxhet dhe Financa;

- *Shqyrtimi dhe miratimi i Plani final të prokurimit të KQZ-së për vitin 2018:*

4. Të ndryshme;

1. Hyrje:

Mbledhja, është kryesuar nga anëtari i KQZ-së, z. Ercan Spat.

Ercan Spat: Janë të gjitha kushtet që të fillojmë mbledhjen e dytë të KQZ-së. Me autorizimin e kryetares, pra në mungesë të saj unë do ta kryesoj këtë mbledhje. E keni rendin e ditës para jush. A ka dikush vërejtje, propozim...?

Jemi prezentë 9 anëtarë, kemi kuroum dhe ju ftojë të votojmë rendin e ditës. Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës me vota unanime.

Ercan Spat: Po vazhdojmë me procesverbalin e mbledhjes së par të KQZ-së nr.01/ 2018. A kemi vërejtje...? Nëse nuk kemi vërejtje, kush është për...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës me vota unanime.

2. Aktivitetet e ZRPP-së:

Shqyrtimi dhe miratimi i draft vendimit për caktimin e lartësisë së mjeteve nga Fondi për mbështetjen e subjekteve politike për vitin 2018

Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPP-së: Zyra ka përgatitur draft – vendimin për caktimin e lartësisë së mjeteve nga Fondi për Mbështetjen Subjekteve Politike për vitin 2018. KQZ përcakton lartësinë e mjeteve nga fondit. Shuma e këtij fondi është 4 milion e 200 mijë euro, dhe ndahet në bazë të ulëseve ose përfaqësimit të mandateve.

Betim Gjoshi: Edhe në të kaluarën, ju e dini që unë kam kërkuar një rregullativë për ndarjen e këtij fondi. Një rregullore të përgjithshme, sepse ne kemi pasur probleme në të kaluarën. Sidomos, kur kemi të bëjmë me lëvizje apo iniciativa, koalicione dhe organizmat të tjerë, ndryshe nga subjektet politike,

sigurisht që ne është dashur të kemi një rregulltve. Është mirë ta kemi normimin e kësaj pjese, sepse po jepet një shumë e buxhetit të Kosovës. Është njëmend mirë që t'i kemi aktet që rregullojnë këtë fond, sepse ne jemi përgjegjës. Është mirë të shohim se si grupet parlamentare, e shpenzojnë fondin. Kemi vazhdimisht realitete të reja në Kuvend, dhe është mirë që kjo të rregullohet.

Binak Vishaj: Situatën që e kemi tani, ajo mund të na përsëritet edhe në të ardhmen kështu që është mirë që ne ta kemi një rregullativë që përcakton se si shpenzohet fondi: edhe tek grupet parlamentare, edhe tek subjektet politike, nismat, koalicionet, siç tha edhe Betimi. E mbështes idenë e Betimit që, ne ta menaxhojmë më lehtë fondin. Pra, parandë publike ta shpenzojmë sipas një rregulltive të përhershme dhe t'i zgjidhë këto çështje procedurale – teknike.

Ercan Spat: Sigurisht, unë pajtohem dhe besoj se edhe kolegët e tjerë janë të këtij mendimi. Pra, ky është një obligim i institucionit tonë, sepse na duhet një normë e këtillë. Ky fond, është mirë që të menaxhohet përmes një akti apo rregullative sepse, i shërben këtij fondi...Ju ftoj ta aprovojme këtë rekomandim të zyrës...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin e zyrës me vota unanime.

3. Raport i Këshillave të KQZ-së:

Këshilli i Operacioneve Zgjedhore

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës i KQZ-së për vitin 2018

Betim Gjoshi: Ne, kemi shqyrtuar disa tema në këshill dhe dy prej tyre i kemi rekomandua për KQZ. E para, ka të bëjë me planin e punës 2018. Gjatë dhjetorit 2017, e kemi miratuar në parim që ka paraparë një mori aktiviteteve. Një pjesë e tyre për shkak të gjetjes së donatorëve, dhe një pjesë tjetër duke e shikuar buxhetin dhe për faktin se s'i po dalim pas zgjedhjeve, na është dashur që ta shikojmë koston financiare dhe afatet...dhe, përfundimisht, e kemi sjellë sot.

Kemi sjellë sot planin, tha z. Gjoshi, e që parasheh kostot, afatet...Nëse nuk gaboj, janë 82 aktivitete. Plani i punës, përfshinë pothuajse të gjitha aktivitetet që i kemi miratuar, dhe një pjesë e tyre vec ka filluar dhe po ashtu, kemi marrë zotime nga Sekretariati se plani është i implementueshëm. Unë, ju ftoj ta votoni...

Ercan Spat: A ka dikush të diskutojë për këtë pikë të rendit...? Nëse jo, a mund ta hedhim në votim...?

Konstatohet se me vota unanime, aprovet Planin e Punës i KQZ-së për vitin 2018

2 Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Projektit për Ditën Globale të Zgjedhjeve

Betim Gjoshi: Ne, jemi anëtarë të asociacioneve të ndryshme. Tashmë, e kemi traditë që ta shënojmë Ditën Globale të Zgjedhjeve. Kemi marrë rekomandime se si ta shënojmë, propozime por për shkak edhe

të kohës së shkurtër, po edhe buxhetit. Kemi punuar shumë, dhe besoj që do ta organizojmë me sukses. Sidomos, në ueb faqen tonë do të pasqyrojmë këtë manifestim. Sekretariati, ka zgjedhur këtë opsion...! Ueb faqja, është e qasshme, dhe ka ndryshime të rëndësishme, është mjaft afirmative...

Le të përmirësohet data në draft...mos të harrohet...! Në këtë pikë, dhe shpjegime produktive edhe z. Enis Halimi, krye shef i SKQZ-së.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan me vota unanime draft - projektin për Ditën Globale të Zgjedhjeve

4.Këshilli për Çështje Ligjore:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarëve të kuvendeve

Sami Hamiti: Kemi shqyrtuar në këshill, dy kërkesa për zëvendësime. Ne, rekomandojmë që këto zëvendësime të aprovohen dhe votohen, meqë janë plotësuar kushtet dhe dokumentacioni është në rregull.

Ercan Spat: Kush është për që, znj. Cenet Sahyadi nga subjekti politik Partia Demokratike Turke e Kosovës, ta zëvendësojë znj. Sevil Kazaz në Kuvendin Komunal të Prizrenit ?

Anëtarët e KQZ-së, me vota unanime miratuan këtë zëvendësim.

Ercan Spat: Kush është për që, z. Cesko Cengiz nga subjekti politik Partia Demokratike Turke e Kosovës, ta zëvendësojë z. Ertan Simitçi në Kuvendin Komunal të Prizrenit ?

Anëtarët e KQZ-së, me vota unanime miratuan këtë zëvendësim.

Ercan Spat: Kush është për që, z. Gazemed Gashi nga subjekti politik AAK, ta zëvendësojë z. Enver Shabanin në Kuvendin Komunal të Suharekës ?

Anëtarët e KQZ-së, me vota unanime miratuan këtë zëvendësim.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për mos pranim të ndryshimit të emrit të partisë politike nga “Bosnjacka Stranka Demokratske Akcije Kosova-BSDAK” në “Evropska Stranka Demokratske Akcije-ESDA”

Sami Hamiti: Po ashtu, në këshill kemi shqyrtuar edhe rekomandimin që ka të bëjë me ndryshimin e emrit të partisë politike “Bosnjacka Stranka Demokratske Akcije Kosova-BSDAK”, në “Evropska Stranka Demokratske Akcije-ESDA”.

Në kuvendin që ata kanë mbajtur, kanë kërkuar që ta ndërrojnë edhe emërtimin, edhe logon e subjektit. Por, në akronim – shkurtësë, i bjen njëjtë. Realisht, i bie njëjtë edhe në akronim, në vokal. Në këshill,

rekomandimi është që të mos pranohet, sepse në gjuhën boshnjake nuk artikullohet “ESDA” por “SDA” dhe kështu nuk kemi ndryshim. Rekomandimi i këshillit pra, është që të mos pranohet, sepse shkakton huti dhe komplet është e njëjta...!

Ilir Gashi: Drejtoreshë, a keni kontaktuar, a ju keni shpjeguar dhe kërkuar që kjo të ndryshohet...?

Miradije Mavriqi: Përfaqësuesi i partisë politike ka dërguar ftesën kur është mbajtur kuvendi. Zyra, u ka dhënë këshilla që, të bazohen në nenin 5 të Rregullës, sepse, nëse simboli ose emri është i ngjashëm me një parti që është e regjistruar më parë, nuk merret parasysh...! Pra, refuzohet...Ata, nuk i janë përmbajtur...

Ilir Gashi: Emri, nuk është i njëjtë, simboli nuk është i njëjtë. Emri dhe inicialet nuk janë të njëjta, shkurtesat janë të njëjta...Realisht, emri nuk është i njëjtë...Nuk e di a jeni konsultuar në këtë mënyrë...!

Miradije Mavriqi: Ne, ua kemi tërhequr vërejtjen që të mos jenë të njëjta, as emri, as shkurtesat dhe as simboli por, emri ka ndryshim...! Mirëpo, ngjyrat e kësaj shkurtese janë shumë të ngjashme...

Ercan Spat: e hedh në votim, propozimin e këshillit për mos aprovim, ashtu siç është edhe e rekomanduar !

Anëtarët e KQZ-së, me vota unanime miratuan rekomandimin e këshillit.

5. Këshilli për Buxhet dhe Financa

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Plani final të prokurimit të KQZ-së për vitin 2018:

Ilir Gashi: Kemi mbajtur takimin e këshillit, dhe kemi trajtuar planin e prokurimit për vitin 2018. E keni para vetës, bashkë me narrativin arsyetues. Pra, ne kemi kërkuar sqarime për çdo njësi të paraparë dhe arsyetime...Plani, është përpiluar edhe mbi bazën e buxhetit...!

Eshref Vishi: Edhe njëherë, mbasi që kam qenë pjesë e këshillit për buxhet, kërkoj sqarime nga administrata lidhur me dy aktivitete prokuruese: furnizimi me lap top dhe me aparate fotokopjuese lidhur me atë se a është aktivitet i AQP-së, apo është aktivitet që duhet ta zhvillojë KQZ. Është debatuar në këshill, mirëpo edhe për anëtarët e tjerë është mirë që të kenë sqarim konkret...

Enis Halimi: Ashtu si u diskutua edhe në këshill, ne kemi pasur një mori takimesh në menaxhment por edhe me zyrtarët e AQP-së, konkretisht me shefin e saj dhe i kemi vendosur jo rastësisht në këto afate për shkak të mundësisë hipotetike që, të kemi një prokurim të centralizuar për këto aktivitete. Atëherë kur nuk arrijmë me pas, pra të kemi edhe opsion rezervë deri në kontratë njëvjeçare. Pra, jemi në biseda dhe kemi zhvilluar biseda produktive edhe për shkak të ngarkesave që kemi...

Stevan Veselinoviq: Lidhur me sigurimin e automjetit, sepse nuk ka numër të saktë... A është vendosur për këtë, apo do të vendoset më vonë...?

Ilir Gashi: Kur e miratuam planin, u akorduam me Sekretariatin që brenda shumë së miratuar, nuk kemi mundur të përcaktohem saktë për sa vutura mund të blihen...Ja kemi lënë Sekretariati që, të përcaktohet në bazë të buxhetit lidhur me këtë...!

Ercan Spat: A kemi diskutime lidhur me planin e prokurimit? Nëse nuk kemi, kush është për aprovimin e planit...?

Anëtarët e KQZ-së, me vota unanime miratuan planin e prokurimit.

Për KQZ

Ercan Spat, anëtar
